

Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi dhe kultura kombëtare

*Ismet Kallaba**

Abstrakt

Ky artikull trajton rëndësinë që kanë mediat e pakicave, në vendet shumë nacionale dhe shumëgjuhësore, siç është Mali i Zi, për informimin e popullatës pakicë dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të tyre. Ai merret specifikisht me mediat në gjuhën shqipe, që ka veçantësitë e saj në raport me mediat e pakicave të tjera, qoftë edhe për shkak të veçorive gjuhësore. Ato luajnë rol të pazëvendësueshëm për prezantimin dhe ruajtjen e kulturës, gjuhës dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi. Artikulli ka për qëllim të analizojë aspekte të ndryshme në raportin e medias shqipe dhe kulturës kombëtare, si dhe ndërvarësinë e tyre. Në kushtet e prirjeve të sotme, kur kultura globale po i zë vendin gjithnjë e më tepër kulturës kombëtare, pyetja që shtrohet është se sa mund të mbijetojë ajo (kultura kombëtare)? Si rast studimi është marrë gazeta “Koha javore”, e vetmja e përjavshme në gjuhën shqipe që botohet në Mal të Zi. Njëra prej veçorive të saj është krijimi i hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare. Artikulli mbron tezën se mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi janë faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kulturës kombëtare, respektivisht identitetit kombëtar, duke qenë se interesimi i publikut këtu për çështje të tilla është parësor.

Fjalë kyç: *medie e pakicës, medie në gjuhën shqipe, identitet kombëtar, kulturë kombëtare, kulturë globale.*

Hyrje

Çështjet e identitetit kombëtar kanë qenë shqetësimi kryesor i shtypit shqiptar, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në periudha të ndryshme, sidomos në kohën kur rrezikohej kombi shqiptar dhe tërësia e tij territoriale. Dihet që rrethanat historike dhe politike të kohës kanë përcaktuar edhe rrugën e zhvillimit dhe natyrën e shtypit shqiptar.

* *Phd. Cand. Ismet Kallaba, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, E-mail: ismetkallaba@gmail.com*

Për këtë arsye, shtypi shqiptar lindi fillimisht jashtë, me qëllim për të ndikuar në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Në qendra të ndryshme evropiane dhe botërore, kolonitë shqiptare nxirrnin organet e tyre të shtypit. Në këtë veprimtari u përfshinë shumë patriotë shqiptarë të cilët, të nxitur nga programi i Rilindjes Kombëtare dhe me qëllim të realizimit të tij, e panë si detyrim moral angazhimin në shtypin e kohës.

Edhe media shqiptare në ish-Jugosllavi, ku shqiptarët edhe pse përbënin popullsinë e tretë në numër gëzonin vetëm statusin e kombësisë, mund të cilësohet si një shtyp në mbrojtje të identitetit kombëtar shqiptar.¹ Zhvillimi i saj është i lidhur ngusht me fatin dhe të drejtat e popullit shqiptar në ish-Jugosllavi. Duke qenë se në Kosovë, shqiptarët përbënin popullsi shumicë, kurse në Maqedoni dhe Mal të Zi popullsi pakicë, është e vetëkuptueshme që “mediat shqiptare në këto republika qenë të eklipsuara nga mediat shqiptare të Kosovës, të cilat mbulonin me informacion dhe programe gjithë popullsinë shqipfolëse në ish-Jugosllavi”.²

Në vendet shumënacionale dhe shumëgjuhësore, siç është Mali i Zi, mediat e pakicave kanë rëndësi të posaçme jo vetëm për informimin e pakicës përkatëse në gjuhën amtare, por edhe për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar. Në krahasim me mediat e pakicave tjera, media në gjuhën shqipe ka veçoritë e saj, në radhë të parë për shkak të gjuhës që ndryshon rrënjësisht nga gjuhët e pakicave tjera.

Duke qenë se artikulli ka për qëllim të analizojë raportin e medias shqipe në Mal të Zi dhe kulturës kombëtare, do të flasim për disa aspekte që ndikojnë në këtë raport dhe ndërvarësinë e tyre.

Media dhe kultura

Mediat pasqyrojnë dhe në të njëjtën kohë kanë ndikim në proceset dhe ndryshimet demokratike të një shoqërie. Sot asnjë vend, pavarësisht

¹ Hamit Boriçi & Mark Marku, “*Histori e shtypit shqiptar – Nga fillimet deri në ditët tona*”, Tiranë, SHBLU, 2010, f. 243.

² Po aty, f. 250.

nivelit të zhvillimit të tij, nuk mund të paramendohet pa media. Ato janë pjesë e kulturës së një vendi.

Studiuesi gjerman i medias Stephan Russ-Mohl thekson se “mediat janë pjesë e fuqishme përbërëse e kulturës e jo vetëm mjete që na mundësojnë të mësojmë, të pushojmë, të rimëkëmbemi dhe të ripërtërijmë energjinë e punës”.³

Media dhe kultura janë të lidhura me njëra-tjetrën. “Mediat janë prodhues serioz të të mirave kulturore”, por ato njëkohësisht edhe informojnë “për të gjitha ngjarjet kulturore, ndërsa me lajmet, recensionet, kritikën dhe format e tjera gazetareske e informojnë publikun për produktet e fundit kulturore si dhe i vlerësojnë në mënyrë kritike dhe me këtë ndikojnë tek opinionin publik”.⁴

Globalizmi mediatik dhe kultura

Globalizmi si fenomen i kohës sonë ka përfshirë edhe mediat dhe kulturën. Kjo ka bërë që edhe raporti i mëparshëm i medias dhe kulturës të ndryshojë. Grupet e mëdha mediatike janë përhapur në të gjithë botën, në forma të ndryshme, duke zgjeruar ndikimin e tyre.

Edhe në fushën e kulturës ka ndodhur imperializmi kulturor, i cili përpiket që kultura e prodhuar në disa vende më të zhvilluara perëndimore, sidomos në SHBA, t’u imponohet vendeve dhe popujve të vegjël. Në këtë luftë, kulturat e vogla kombëtare nuk kanë mundësi të përballen me kulturën e masave, e cila sot mbisundon kulturën e dikurshme elitare.

Kjo prirje është reflektuar edhe në media. Bile është vetë media ajo që ndikon në përhapjen e kësaj kulture. Siç vëren Colombo, “ekziston prirja për të krijuar një rrjet komunikimi ndërkombëtar pa identitet dhe gjurmë kulturore, që mbulon vende të ndryshme dhe bën

³ Stephan Russ-Mohl & Ana Jugoslava Zagorac-Keršer, *Novinarstvo*, Beograd, Clio, 2005, f. 25.

⁴ Stjepan Malović, „Odnos masovnih medija i kulture“, *Kolo 2*, 2005, *mund ta shihni në* <http://www.matica.hr/kolo/299/Odnos%20masovnih%20medija%20i%20kulture/> (parë për herë të fundit më 21/05/2015).

interpretime të ndryshme”.⁵ Ka ndryshuar po ashtu edhe forma e raportimit për kulturën në media. “...shumë gjëra që nga vitet ’90 kanë ndryshuar e janë zhvendosur, sidomos nga ‘E’ në ‘Z’, domethënë ikje nga elitarizmi për të ardhur drejt ofertave më zbavitëse. Rubrika klasike kulturore, e lidhur fort pas teatrit, koncerteve dhe kritikës së librave, u plotësua me oferta të tjera që i kushtohen më shumë kulturës së popullit, temave të stilit të jetesës e sidomos kultit të VIP-ave”.⁶

Çdo gjë në media sot bëhet në përputhje me kërkesat e publikut. “Format tradicionale të raportimit për kulturën janë zëvendësuar me forma të reja. Kultura ‘klasike’ në televizion është shmangur krejt nga kultura Pop dhe Talk, e kjo jo vetëm në stacionet private”⁷, por edhe në mediat publike.

Globalizmi kulturor shikohet sot si një fenomen i pandalshëm, i cili është vështirë që të luftohet. Prandaj, në këto rrethana kur kultura globale, e cila mbështetet në parime thjesht komerciale, po i zë vendin gjithnjë e më tepër kulturës kombëtare, pyetja që shtrohet është se sa mund të mbijetojë ajo (kultura kombëtare)?

Media malazeze dhe kultura shqiptare

Mediat malazeze synojnë të unifikojnë etnikisht gjithë hapësirën mediatike në Mal të Zi. Kjo prirje bën që pakicat të mos kenë hapësirë të mjaftueshme në këto media. Si pasojë e kësaj, në to mungojnë temat që merren me problemet e shqiptarëve si pakicë në Mal të Zi.

Shqiptarët në Mal të Zi përbëjnë grupin e pazëshëm, duke i eliminuar nga sfera publike. Kjo “heshtje mediatike” është pjesë e politikës redaktuese të mediave malazeze ndaj shqiptarëve. “Ato pak përmbajtje që trajtojnë shqiptarët në Mal të Zi kanë të bëjnë kryesisht

⁵ Furio Colombo, *Lajmet e fundit mbi gazetarinë*, Tiranë, Instituti Shqiptar i Medias, f. 30.

⁶ Stephan Russ-Mohl, *Gazetaria*, Tiranë, K&B, 2010, f. 223.

⁷ Po aty, f. 226.

me politikën dhe me kronikën e zezë”⁸, kurse kultura shqiptare është e anatemuar në mediat malazeze sepse të shkruash për kulturën e një populli tjetër, në këtë rast kulturën shqiptare, do të thotë të shkruash mirë për të. Si rrjedhim, mund të thuhet se “në aspektin sasior, shqiptarët janë të nënperfaqësuar, kurse në aspektin cilësor të keqprezantuar në median malazeze”.⁹

Mediat e pakicave dhe kultura kombëtare

Mediat e pakicave kanë rol të shumëfishtë pasi që nuk kanë qëllim vetëm të informojnë, edukojnë, argëtojnë etj., por ato janë mjet i rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar të pakicës përkatëse. Në këtë kontekst, kultura kombëtare është vetëm njëri prej elementeve të formësimit të identitetit kombëtar.

Në rastin e mediave të pakicave në Mal të Zi, veçori është se përmbajtjet e tyre janë shumë monoetnike. Pjesën më të madhe të hapësirës në to e zë raportimi mbi pakicën e vet, pastaj raportimi mbi popullin shumicë, ndërsa më së paku hapësirë i kushtohet raportimit për pakicat tjera. Kjo vlen edhe për mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi.

Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi janë të lidhura ngusht me të drejtat e shqiptarëve në këtë vend dhe identifikohen me problemet e tyre. Politika e tyre redaktuese përcaktohet a priori nga qenia e shqiptarëve pakicë kombëtare në këtë vend. Ashtu siç thotë Colombo se “identifikimi kombëtar i gazetarit ka shumë rëndësi dhe lë gjurmë në punën e tij, sepse i lejon të gjejë një këndvështrim që u prin udhë lexuesve apo shikuesve”¹⁰, kjo vlen edhe për mediat shqipe në Mal të Zi.

Zhvillimi dhe roli i medias në gjuhën shqipe në Mal të Zi mund të krahasohet me shtypin shqiptar të periudhës së Rilindjes Kombëtare, edhe pse në një kontekst krejt tjetër kohor. Një numër i revistave,

⁸ Ismet Kallaba, “Imazhi i shqiptarëve në mediat e shkruara malazeze”, në *Studime albanologjike – Diversiteti Kulturor në media*, VII, ff. 19-26, Tiranë, 2014, f. 23.

⁹ Po aty, f. 24.

¹⁰ Colombo, op. cit., f. 29.

kryesisht kulturore, botohen herë pas here, pa një periodicitet të qartë, por vetëm kur sigurohen paratë për botimin e saj. “Temat të cilat trajtojnë zakonisht janë problemet e jetës së përditshme të shqiptarëve në Mal të Zi, aktivitetet e partive politike dhe çështje të tjera me rëndësi për identitetin e shqiptarëve”.¹¹ Por ato nuk raportojnë vetëm për shqiptarët në Mal të Zi, por përpiqen të mbulojnë tërë hapësirën mbarëshqiptare, duke e parë atë si një hapësirë të unifikuar.

Kultura shqiptare zë hapësirën kryesore në këto media, duke qenë se ajo shikohet si element i rëndësishëm i ruajtjes dhe i zhvillimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve. Njëri prej shkaqeve kryesore është se mediat e shumicës, jo vetëm ato private por edhe ato publike, nuk i kushtojnë vëmendjen dhe hapësirën e duhur kulturës shqiptare. Këtë e vë në pah edhe raporti i Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut “Informimi në gjuhët e pakicave dhe përmbajtjet mbi kulturën dhe traditën e popujve pakicë në Shërbimin publik në Mal të Zi”¹². Për rrjedhojë, mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi janë i vetmi vend për informimin dhe promovimin e kulturës që krijohet nga shqiptarët në Mal të Zi.

Duke qenë se mediat janë edhe reflektim i shoqërisë në të cilën ajo vepron, mediat shqipe në Mal të Zi, ndonëse para së gjithash i kushtojnë vëmendje kulturës kombëtare, pasqyrojnë edhe kulturat e popujve të tjerë që jetojnë në Mal të Zi.

Sa i përket formave të shfaqjes së kulturës, në kohën kur ka një sulm të kulturave të tjera të mëdha që përmes medias të ndikojnë tek opinioni, qoftë nëpërmjet telenovelave, importimit të modeleve të gatshme kulturore etj., media në gjuhën shqipe në Mal të Zi mundohet t’u bëjë ballë këtyre tendencave të sotme globale.

¹¹ Ismet Kallaba, “Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi dhe sfidat e tranzicionit”, në *Studime albanologjike – Gazetari dhe shkenca komunikimi*, III, ff. 164-170, Tiranë, 2010, f. 166.

¹² Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, *Informimi në gjuhët e pakicave dhe përmbajtjet mbi kulturën dhe traditën e popujve pakicë në Shërbimin publik në Mal të Zi* (Monitorimi i të drejtave të njeriut në Mal të Zi), Podgoricë, 2009.

“Koha javore”¹³ në mbrojtje të kulturës kombëtare

Gazeta “Koha javore”, e përjavshmja e vetme në gjuhën shqipe në Mal të Zi, është shembulli më tipik i përfaqësimit të kulturës kombëtare në median shqipe në Mal të Zi. Përzgjedhja e saj është bërë thjesht për lehtësi studimi.

Përkundër faktit se “Koha javore” që nga fillimi i saj është financuar nga buxheti shtetëror, politika e saj redaksionale ka pasur gjithnjë synim mbrojtjen e vlerave kulturore dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve. Sipas redaktorit përgjegjës Ali Salaj, kjo gazetë “ndjek një politikë afirmuese redaksionale dhe tenton që ta orientojë dhe nxisë maksimalisht lexuesin drejt kulturës autoktone, me dëshirën që kultura të mbetet një sfidë e përjetshme në aktivitetin intelektual të tij”.¹⁴

“Koha javore” i kushton një hapësirë të konsiderueshme kulturës kombëtare duke e parë atë “si pjesën më të rëndësishme dhe shtyllën mbështetëse në ruajtjen e identitetit kombëtar”¹⁵, por sidomos “e mbështet kulturën e shqiptarëve në Mal të Zi, e cila me veçantitë e veta po mbijeton fuqishëm në mozaikun e kulturës mbarëkombëtare.”¹⁶ Redaktori përgjegjës Salaj thotë se “duke marrë parasysh se kultura e shqiptarëve në Mal të Zi fare pak ose aspak nuk pasqyrohet në mediat shqipe në rajon, atëherë roli i gazetës ‘Koha javore’ është edhe më i rëndësishëm, pasi ajo shndërrohet në një arkivë të ruajtjes dhe sistemimit të kulturës së një komuniteti”.¹⁷

Edhe pse në këtë gazetë vetëkuptohet që dominon pasqyrimi i kulturës që krijohet nga shqiptarët në Mal të Zi, ajo shikohet si pjesë e pandarë e mozaikut kulturor mbarëkombëtar. Njëra prej veçorive të saj është krijimi i hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare. “Panteoni i personaliteteve të kulturës shqiptare që kanë zënë vend në

¹³ Gazeta “Koha javore” është themeluar me vendim të Kuvendit të Malit të Zi. Numri i saj i parë doli në shkurt 2002.

¹⁴ Intervistë me Ali Salaj, redaktor përgjegjës i gazetës “Koha javore” (19.05.2015).

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

'Koha javore' është mbarëshqiptar: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Çamëria, shqiptarët e Rumanisë, arbëreshët apo diaspora në Perëndim me një spektër të gjerë tematik nga letërsia, publicistika, përkthimi, albanologjia, gjuhësia, monografia, artet pamore etj."¹⁸

Përkundër prirjeve edhe të mediave më prestigjioze për t'u afruar sa më shumë publikut të gjerë, "Koha javore" vazhdon të jetë konservatore në rubrikat e saj të kulturës. Kultura që ofrohet në këtë gazetë i ofrohet më tepër shtresës intelektuale sesa masës. Kjo bëhet me qëllim sepse roli i kësaj gazete të vetme në gjuhën shqipe në Mal të Zi është para së gjithash edukimi i lexuesit shqiptar me kulturë kombëtare elitare.

Përfundime

Roli i identitetit kombëtar, etnik e kulturor është përcaktues për funksionimin e mediave në gjuhën shqipe në Mal të Zi. Pavarësisht nivelit të tyre dhe faktit se ato nuk përbëjnë burimin e parë të informimit për një pjesë të madhe të shqiptarëve në Mal të Zi, të cilët përpos mediave në gjuhën shqipe informohen edhe nga burime të tjera, si mediat malazeze dhe mediat shqiptare në rajon, mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi janë faktor i rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare, respektivisht identitetit kombëtar të shqiptarëve në këtë vend.

Nëpërmjet politikës së tyre redaksionale, ato synojnë të formojnë vetëdijen te publiku se shqiptarët janë një komb, pavarësisht se janë të ndarë në vende të ndryshme. Kultura kombëtare shihet si njëri prej elementeve më të rëndësishëm të identitetit kombëtar. Për këtë arsye, mediat shqipe në Mal të Zi përpiqen me çdo kusht të mbrojnë kulturën kombëtare nga invazioni i kulturës globale. Në këtë drejtim, njëra prej veçorive të mediave shqipe në Mal të Zi është krijimi i hapësirës së përbashkët kulturore gjithëshqiptare, ku kultura e shqiptarëve në Mal të Zi zë vend të veçantë.

¹⁸ Valbona Karakaçi, "Çështje të identitetit të pakicave përmes shtypit shqip në Malin e Zi", kumtesë e mbajtur në Takimin VII Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca.

Bibliografia

Boriçi, Hamit & Marku, Mark, *Histori e shtypit shqiptar – nga fillimet deri në ditët tona*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2010.

Colombo, Furio, *Lajmet e fundit mbi gazetarinë*, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë.

Intervistë me Ali Salaj, redaktor përgjegjës i gazetës “Koha javore” (19.05.2015).

Kallaba, Ismet, “Imazhi i shqiptarëve në mediat e shkruara malazeze”, në *Studime albanologjike – Diversiteti Kulturor në media*, VII, ff. 19-26, Tiranë, 2014.

Kallaba, Ismet, “Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi dhe sfidat e tranzicionit”, në *Studime albanologjike – Gazetari dhe shkenca komunikimi*, III, ff. 164-170, Tiranë, 2010.

Karakaçi, Valbona, “Çështje të identitetit të pakicave përmes shtypit shqip në Malin e Zi”, kumtesë e mbajtur në Takimin VII Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca.

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, *Informimi në gjuhët e pakicave dhe përmbajtjet mbi kulturën dhe traditën e popujve pakicë në Shërbimin publik në Mal të Zi* (Monitorimi i të drejtave të njeriut në Mal të Zi), Podgoricë, 2009.

Russ-Mohl, Stephan & Zagorac-Keršer, Ana Jugoslava, *Novinarstvo*, Beograd, Clio, 2005.

Russ-Mohl, Stephan, *Gazetaria*, Tiranë, K&B, 2010.

Burime nga interneti

Malović, Stjepan, „Odnos masovnih medija i kulture“, *Kolo 2*, 2005, mund ta shihni në <http://www.matica.hr/kolo/299/Odnos%20masovnih%20medija%20i%20kulture/> (parë për herë të fundit më 21/05/2015).